



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

24/06/2024

Nr. i Protokollit: 02/ 689

## Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Mollopolc

E enjte, më 14 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: 19:45- 21:00

Vendi i takimit: SHF "Bajram Curri"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori për Buxhet dhe Financa – Besnik Ahmeti, Drejtori i drejtorisë për Planifikim Urban Kadastër dhe Gjeodezi – Grejtalb Emmini, Asambleistët – Besnik Seferi, Asllan Beqaj, Sanie Sadiku,

Rendi i ditës:

### 1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

**Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi** : Përhëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Ky takim ka të bëjë me buxhetin domethënë me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, si zakonisht çdo vit në muajin qershor kur kalon si informatë në Kuvend obligohemi ligjërisht që të mbajmë dëgjime publike me qytetarët. Ne i kemi filluar dje dëgjimet publike me qytetarët dhe sot jemi në fshatin e tetë që po marrim pjesë, ne duhet që deri më datën 20 qershor t'i përfundojmë dëgjimet publike për shkak të procedurave pasi që ky material do të shkojë në Kuvend për votim. Realisht ne sot këtu jemi vetëm për të marrë kërkesat nga banorët e fshatit Mollopolc për investimet e reja të cilat do të vijnë në vitin 2025.

Tani dua të ndalem pak te buxheti, për vitin 2025 buxheti i planifikuar është afër 11 milion euro, është fat i mirë që çdo vit buxheti në komunën e Shtimes po rritet, në vitin e kaluar e kemi pasur afërsisht 10 milion ndërsa tani këtë vit e kemi afër 11 milion euro.

Buxheti i Komunës së Shtimes, diku 50% shkon në paga dhe mëditje që kap vlerën rreth 6 milion euro, pastaj kemi investimet kapitale që parashihen të jenë 2 milion e 700 mijë, 1 milion e gjysëm janë për mallra dhe shërbime, 250 mijë euro parashihen të jenë për shpenzimet e institucionet të Komunës së Shtimes. Kësisoj buxheti prej të gjitha llojeve të kategorive ndërtohet.

Tani ju kisha lutur që t'i paraqisni kërkesat e juaja, për secilën lagje apo edhe tërë fshatin në përgjithësi.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- Mentor Neziraj: Një kanalizim të cilën e kam kërkuar tek lokali dua të dijë a është në buxhet që të bëhet për këtë vit apo jo ?  
Po ashtu edhe në lagjen “Neziraj”, kemi nevojë për ndriçim dhe trotuar.
- Ismet Salihu: Së pari e kam një pyetje për ju, Kulla e zonës a hyn me nivel të fshatit apo me nivel të Komunës?  
Oborri i kullës duhet rregulluar, shkallët po ashtu edhe kanalizimi.  
Shkolla e vjetër të hiqet dhe në vend të saj të ndërtohet ndonjë fushë futbollit ose fushë për sporte të ndryshme. Gjërat publike është mirë që të rregullohen ku frekuenton fshati më shumë.  
Të bëhet një shteg për ecje tek Ujëvarat e Mollopolcit, është mirë që të hapet rruga dhe të bëhet me zhavorr.
- Xhemajl Mujota: Ne si fshat dhe ju si Komunë duhet të bëjmë më shumë sa i përket Kullës së Zonës operative të Noredimes, pasi që është bërë shumë pak. Të gjitha pjesët të cilat kanë mbetur pa rregulluar sikurse oborri, shkallët, kanalizimi duhet të rregullohen.  
Të bëhen pllakata me emërtim sa i përket pjesëve ku gjatë luftës janë shfrytëzuar si spitale, shtabe.
- Shaban Salihaj: Tek pjesa e shkollës është mirë që të bëhet një fushë e sportit, meqenëse pjesa e epërme e ka një fushë të sportit kështu që është e nevojshme edhe këtu ta kemi një. Fusha e sportit është mirë që te jete e gjelbërt dhe jo me beton. Po ashtu do të ishte mirë edhe një park të vogël të bëhet tek pjesa ku ne e quajm “Mbi mrize”.
- Fadil Neziraj: Një park është i nevojshëm tek pjesa lart, po ashtu është i nevojshëm një trotuar deri tek fusha e sportit dhe ndriço ashtu është i nevojshëm një trotuar deri tek fusha e sportit dhe ndriçim kemi nevojë në atë pjesë.
- Alban Neziraj: Në rrugën “Hamz Jashari”, të rregullohet ndriçimi. Po ashtu edhe një pyetje kur do t’i largoni trapat të cilët janë në rrugë.  
Cka po ndodh me Lumin tek pjesa ku janë sjellë disa kur dhe më nuk janë hequr?  
Pastrimi i Lumit kur do të bëhet?
- Kosovar Roshaj: Vitin e kaluar kur keni qenë është dhënë një kërkesë që brenda këtij viti të përfundoj trotuari prej shkollës deri ka rruga Zona e Noredimës, desha të dijë deri keni arritur dhe kur do të përfundoj ?
- Reshat Mujota: Transporti për nxënësit. Kanalizimi i Kullës të bëhet dhe oborri të rregullohet.  
Shtrati i lumit të rregullohet si dhe shtegu për ecje për tek ujëvarat.  
Shkolla e vjetër duhet të rrënohet, pasi që nxënësit luajnë në ato pjesë dhe mund të rezikohen dhe të lëndohen.

Procesmbajtës,  
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Mollopoc  
Date: 14/06/2024

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Klodian Mujota	Klodian Mujota
2	Shobor Selihu	Shobor Selihu
3	MENTOR NEZIROJ	Mentor Neziroj
4	Muhamet Qerizë OSA D+	Muhamet Qerizë OSA D+
5	KOSVAR ROSHAT	Kosvar Roshat
6	ISMET SOPAJ	Ismet Sopaj
7	Alban Neziroj	Alban Neziroj
8	Ismet Selihu	Ismet Selihu
9	Reshat Mujota	Reshat Mujota
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		
17		